



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KRYETARI

Nr. 314 prot.

Korçë më, 15 / 01 / 2019

URDHËR

Nr. 18, datë 15/01/2019

Për një shtesë në urdhërin nr. 138, datë 21.03.2017, "Për miratimin e orareve dhe stacioneve të qëndrimit të linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar

Pasi shqyrtova relacionin e datës 14.01.2019, paraqitur nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit, lidhur me oraret e funksionimit dhe stacionet e qëndrimit të linjës të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve, Vinçan-Korçë-Vinçan, mbështetur në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15, neni 19; ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 64, pika b; udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar, neni 3; vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 17, datë 03.03.2017, pika 2, "Për miratimin e linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit", i ndryshuar;

ËRDHËROJ:

1. Në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 138, datë 21.03.2017, "Për miratimin e orareve dhe stacioneve të qëndrimit të linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar, për Njësinë Administrative Voskop, kryhet shtesa për linjën Vinçan-Korçë-Vinçan, oraret e nisjes e kthimit dhe stacionet e qëndrimit do të jenë si më poshtë:

1.	LINJA NR. 6/4	Vinçan – Korçë – Vinçan
2.	Oraret e nisjes	07 ⁰⁰ , 12 ³⁰ .
3.	Oraret e kthimit	07 ³⁰ , 13 ³⁰ .
4.	Stacionet	Vinçan & Korçë.

2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe Policia Bashkiake Korçë.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi
N. Lika

Drejtonia Juridike
A. Dishnica

KRYETARI
Sotirag Filo

